



Prishtinë: 20.12.2011

Kodi i ZRRE-së: V_391_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_683_11_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, Nenit 17 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_683_11_11**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 30.11.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e përfaqësuesit të KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Eqrem Hasanaj (shifra në KEK: DPZ – 3738), nga Theranda si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Përfaqësuesi i KEK-ut në ankesën e tij drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 30.11.2011 ka apeluar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_683_11_11 për konsumatorin Eqrem Hasana, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 28.01.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 6362280 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 39960280, ku kanë theksuar se ndërrimi i njehsorit bëhet pasi qe ka xhamin e thyer.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0798, e datës 28.01.2008
- Me datë 22.03.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 6362280 ku është konstatuar se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka në rregull, njehsori elektrik është pa qelq, në brendi të njehsorit numëruesi është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa të numëruesit, tabela e njehsorit është e dëmtuar e gërvishtur dhe shifrat e manipuluar.
Provë: Procesverbal i KEK-ut nr. 7/26 e datës 22.03.2008
- Me datë 14.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori ku kanë theksuar se ne momentin e kontrollës dhe me kërkesë te konsumatorit me nr. 2739 kemi vërejtur se njehsori i ri është i bllobuar dhe tërësisht është në rregull, mirëpo njehsori i vjetër i ndërruar në mënyrë zyrtare nga gjithashtu ka procesin e kalibrimit, theksohet se gjendja e fundit sipas procesverbalit për ndërrim njehsorit nr. 0798 gjendja e fundit është I 60860 II 00668, ndërsa në frakturë I 79361, II 01045, gjithashtu konsumatori kërkon stornimin e fakturës së njehsorit të vjetër.



Provë: Procesverbali i KEK-ut, nr. 0108904 i datës 14.05.2008

- Me datë 29.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatori dhe kanë konstatuar se njëhori elektrik ka procesin e kalibrimit, gjithashtu është theksuar se procesverbalit i bashkëngjiten fotot e njëhorit të vendosur.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0113535 i datës 29.05.2008

- Me datë 13.06.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04329 në vlerë prej 2,853.01€.

Provë: Fatura DPZ08HP04329 e datës 13.06.2008

- Me datë 03.07.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK e datës 03.07.2008

- Me datë 03.07.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kalibrimit dhe kontrollës.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 03.07.2008

- Me datë 07.07.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së, datë 07.07.2008

- Me datë 16.11.2011 DMK ka lëshuar vendimin duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPZ08HP04329 e datës 13.06.2008 në vlerë prej 2,853.01€.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar vendimin e lëshuar nga DMK nr. **ZRRE/DMK_V_683_11_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së.

Përfaqësuesi i KEK-ut në ankesën e tij ka prezantuar vendimin e Gjykatës Komunale të Suharekës nr. P.nr.289/08 të datës 29.06.2010 në të cilin gjykata ka dënuar me gjobë konsumatorin Eqrem Hasanaj në vlerë prej 150 € (njëqindpesëdhjetë euro), si dhe të dëmtuarën KEK e ka udhëzuar që për demin e shkaktuar ta kërkojë në kontest civil.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur ka bërë shqyrtimin e lëndës së konsumatorit sa i përket faturës së rikthimit të humbjeve me të cilën është ngarkuar konsumatori nga KEK-u. Pas shqyrtimit dhe analizimit të hollësishëm të lëndës së konsumatorit nuk ka gjetur elemente me të cilin vërtetohet se konsumatori i ka shkaktuar dëm KEK-ut sa i përket shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Andaj Bordi i ZRRE-së duke u bazuar në këtë si dhe arsyet e paraqitura në vendimin e DMK-së **refuzon** ankesën e KEK-ut, si dhe ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK_V_683_11_11** të mbetet në fuqi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar